



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Nr.704 Rregj.Them.

Nr. 5934/13 Vendimi

Date Rregjistrimi 24.04.2025

Tiranë më datë 07.07.2025

V E N D I M

“PËR DEPOZITIM VENDIMI NË REGJISTRIN E OJF-ve”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË, E PERBERE NGA:

MANJOLA XHAXHO – GJYQTARE

Në Tiranë, më datë 07.07.2025, asistuar nga sekretare gjyqësore Daniela Zharri mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket palës:

Kërkues: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), përfaqësuar, nga Presidenti z. Fidel Ylli”, me adresë rr. “Liman Kaba”, parku Olimpik, Tiranë.

Objekti: Depozitimi dhe regjistrimi vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore të 31-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Baza ligjore: Ligji nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" dhe Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"; ligj nr. 79/2017 “Për sportin”.

V Ë R E N

Pala kërkuese është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është regjistruar si organizatë jofitimprurëse në formën e shoqatët pranë regjistrimit të OJF-ve me vendimin nr. 5934 , datë 22.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, pala kërkuese ka kërkuar depozitim në regjistrin e OJF-ve, të vendimeve të marra më datë 23.04.2025, në Asamblenë e Përgjithshme Zgjedhore të 31-të, me të cilin është vendosur:

1. *Vendim Nr.1 – Miratimi i rendit të dites së Asamblese së 31-të Përgjithshme Zgjedhore të KOKSH*
2. *Vendim Nr.2 – Ratifikimi i vendimeve të marra në Asamblenë e Përgjithshme nr.30 të datës 5 Tetor 2024.*
3. *Përditësimi i Asamblesë së KOKSH nga Presidenti z.Fidel YLLI, përfshirë vendimin e KE në lidhje me kërkesat e parashtruara në letrën e FSHF të datës 31 Mars 2025.*
4. *Ndarja e cmimit "Urdher Olimpik".*
5. *Vendim Nr.3- Miratimi i z.Indrit Cullhaj i zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve për të qenë anëtar i KE të KOKSH.*
6. *Votimi për kandidatët për KE (President, Zv.President dhe Anëtar).*
7. *Shpallja e rezultatit të votimit*

Vendim Nr.4 – Përzgjedhja e z. Fidel Ylli si President i KOKSH

Vendim Nr.5 – Përzgjedhja e z. Erlind Pëllumbi si Zv.President i KOKSH

Vendim Nr.6 – Përzgjedhja e kandidatëve të mëposhtëm si anëtarë të KE (Komiteti Ekzekutiv):

1. *Alfred Tahiraj*
2. *Enkelejda Caushi*
3. *Florend Kalivopulli*
4. *Izmir Smajlaj*
5. *Julinda Dhame*
6. *Krenar Dila*
7. *Leonard Lulaj*
8. *Pavlina Ylli*

Gjykata pasi u njoh me kërkesën dhe sqarimet në seancë të përfaqësuesit të palës kërkuese që kërkon të regjistrojë vendimet e marra në mbledhjen e mësipërme, si dhe me dokumentacionin e regjistrimit të kësaj shoqate, e gjeti kërkesën të bazuar në ligjin nr.8788 datë 07.05.2001 "Për

organizatat jofitimprurëse”, dhe ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshaur, si dhe në statutin e shoqatës, dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

.Në baze te ligjit nr. 8788 date 07. 05. 2001, Gjykata

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Depozitimn në regjistrin e OJF-ve të vendimeve date 23.04.2025 të Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit si më poshtë:

Vendim Nr.1 – Miratimi i rendit të dites së Asamblese se 31-të Përgjithshme Zgjedhore të KOKSH

Vendim Nr.2 – Ratifikimi i vendimeve të marra në Asamblenë e Përgjithshme nr.30 të datës 5 Tetor 2024.

Vendim Nr.3- Miratimi i z.Indrit Cullhaj i zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve për të qenë anëtar i KE të KOKSH.

Vendim Nr.4 – Përzgjedhja e z. Fidel Ylli si President i KOKSH

Vendim Nr.5 – Përzgjedhja e z. Erlind Pëllumbi si Zv.President i KOKSH

Vendim Nr.6 – Përzgjedhja e kandidatëve të mëposhtëm si anëtarë të KE:

1. Alfred Tahiraj
2. Enkelejda Caushi
3. Florend Kalivopulli
4. Izmir Smajlaj
5. Julinda Dhame
6. Krenar Dila
7. Leonard Lulaj
8. Pavlina Ylli

3.Shpenzimet gjyqesore i ngarkohet pales kerkuese.

4.Urdhërohet, Zyra e Regjistrin të OJF-ve pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të kryej veprimet përkatëse për regjistrimin e këtij vendimi.

5. U shpall në Tiranë me datë 07.07.2025.

SEKRETARE

DANIELA ZHARRI




Tabela e shpenzimeve gjyqësore

Nr	Shpenzime gjyqësore	Pala qe ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor			Sasi	Çmim	Vlere
		Gjykata	Paditës	Te Paditur			
1	Tarife gjyqësore				1	1,000	1,000
2	Shpenzime njoftimi				1	150	150
	Shuma						1,150 lekë